



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 28, datë 17.09.2025

**PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS SË ZONJËS
NAUREDA LLAGAMI NË VENDIN VAKANT, PËR GJYQATAR NË
GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA GJYKATA E LARTË MË
DATË 11.12.2024**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Sokol Sadushi	Kryetar
Marjana Semini	Zëvendëskryetare
Ilir Toska	Anëtar
Alma Muça	Anëtare
Fuat Vjerdha	Anëtar
Enkela Vlora	Anëtare relatore
Irma Balli	Anëtare
Nafije Hasko	Anëtare
Etien Kapo	Anëtar

Asistuar nga sekretare Katerina Bilo me praninë e Avokates së Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), në mungesë të përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në mbledhjen e datës 17.09.2025, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATES: Naureda Llagami

OBJEKTI: Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidaturës së Znj. Naureda Llagami, në vendin vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 11.12.2024.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

*Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302*

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së KED-it, zonjës Enkela Vlora, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në përfundim të procedurës së verifikimit për këtë kandidate, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 17, datë 17.06.2025 ka vendosur *“Lejimin e kandidimit të kandidates Naureda Llagami, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 11.12.2024”*, vakancë e krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas deklarimit të mbarimit të mandatit të gjyqtares Holta Zaçaj.

2. Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8577/2000 dhe të ligjit nr. 115/2016, si edhe atyre të Kreut IV (pikat 27-38) të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 *“Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, anëtarja e Këshillit, znj. Enkela Vlora, në cilësinë e relatores të vendit vakant të cituar më lart, ka realizuar veprimet përgatitore të procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, njëkohësisht me procedurat e verifikimit të tyre.

3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi shqyrtoi procedurat e ndjekura gjatë veprimeve përgatitore nga relatorja dhe plotësinë e dokumentacionit të paraqitur për vlerësim nga secili kandidat, dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për përgatitjen e dokumentacionit të kandidatëve, me vendimin e datës 09.09.2025 ka vendosur fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas deklarimit të mbarimit të mandatit të gjyqtares Holta Zaçaj.

4. Bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidatja Naureda Llagami në momentin e kandidimit dhe gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, anëtarja e Këshillit, relatore e vendit vakant në të cilën ky kandidat ka paraqitur kandidaturën e tij, hartoi relacionin përkatës për gjetjet në procedurën e vlerësimit dhe të pikëzimit të kësaj kandidate për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, i cili i është njoftuar kandidates.

5. Kryetari i Këshillit me vendimin nr. 25, datë 11.09.2025 ka thirrur mbledhjen e Këshillit në datën 16.09.2025, ora 13:00, për zhvillimin e intervistës dhe testimin e njohurive të gjuhës së huaj me kandidatët e lejuar. Me email-in e datës 12.09.2025, kandidatja u njoftua për vendimin për caktimin e datës së intervistës dhe testimit të gjuhës së huaj si dhe caktimin e ekspertës. Kandidatja Naureda Llagami mori dijeni dhe

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

përzgjedhi të intervistohet në gjuhën e huaj “Anglisht”, si dhe duke deklaruar se nuk ka shkaqe papajtueshmërie me ekspertin.

6. Intervista mbi motivimin e kandidimit me kandidaten Naureda Llagami, si dhe intervista në gjuhën e huaj “Anglisht”, u zhvilluan në mbledhjen e Këshillit të datës 16.09.2025.

II. Parimet dhe burimet ligjore që udhëheqin vlerësimin

7. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) vepron mbi bazën e Kushtetutës dhe Ligjit nr. 115/2016, duke zbatuar rregullat procedurale të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 (procedura e verifikimit) dhe metodologjinë e Vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 (kriteret/peshët e pikëzimit). Këto akte garantojnë kompetencën e organit, rregullshmërinë formale dhe mjetet e transparencës për një vendimmarrje të arsyetuar, të verifikueshme dhe të drejtë. Parimet mbizotëruese: (i) ligjshmëria, (ii) barazia dhe mosdiskriminimi, (iii) paanësia dhe shmangia e konfliktit të interesit, (iv) e drejta e dëgjimit dhe transparenca, (v) proporcionaliteti dhe arsyetimi, (vi) parashikueshmëria dhe konsistenca në zbatimin e kriterëve.

8. *Rregullshmëria procedurale (shorti, njoftimet, verifikimi, votimi).*

Procesi i vlerësimit nisi me caktimin me short të relatorit dhe përcaktimin e këshilltarëve ligjorë; vijoi me njoftimet ndaj institucioneve dhe kandidatëve, administrimin e materialeve, verifikimet sipas Vendimit nr. 4 (përfshirë kontrollet e integritetit, pasurisë dhe papajtueshmërisë) dhe me mbledhjen ku bëhet diskutimi i raporteve dhe votimi i hapur. Publikimi i rezultatit dhe përgatitja e “raportit të arsyetuar” siguron transparencën e aktit përfundimtar.

9. Respektimi i këtyre hapave është kusht i domosdoshëm për ligjshmërinë e pikëzimit: dështimi në cilindo hap do të çenonte aktin. Në rastin konkret, dokumentet e administruara dhe tabelat përfundimtare pasqyrojnë ecuri të përputhur me skemën ligjore.

9. *Metodologjia: kriteret dhe “mesatarja kolegjiale”.*

Metodologjia e KED strukturohet në tri blloqe: (1) Meritat Profesionale (deri 60 pikë), (2) Meritat Morale (deri 30 pikë), (3) Meritat Organizative/Drejtues-Menaxheriale (deri 10 pikë). Brenda secilit bllok, nën-kriteret dhe indikatorët janë të paracaktuar (p.sh., vjetërsi/arsim/“pesë dokumente”/gjuhë për bllokun profesional; integritet/reputacion për bllokun moral; platforma/vizioni për bllokun organizativ).

10. Çdo anëtar i KED vlerëson individualisht; rezultati përfundimtar është mesatarja e pikëve të 9 anëtarëve (“mesatarja kolegjiale”). Kjo teknikë zvogëlon ndikimin e çdo skaji individual (shumë i lartë ose shumë i ulët) dhe e bën totalin produkt të një vlerësimi kolegjial, jo të një individi. Për rrjedhojë, edhe kur anëtarët ndryshojnë në nuanca, ligjshmëria e vendimit ruhet nëse kriteret zbatohen njësoj dhe arsyetimi është i pranishëm.

11. *Testet e ligjshmërisë së vlerësimit (kontrolli i brendshëm i KED).* Për të qenë i qëndrueshëm juridikisht, pikëzimi kalon disa “teste” të brendshme kontrolli:

-Testi i kompetencës dhe formës: organi i duhur, akti në formën e ligjit dhe rregullit të brendshëm; procesverbalet dhe tabelat ekzistuese;

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

- Testi i procedurës: shorti, njoftimet, verifikimi, e drejta e dëgjimit, mbledhja, votimi i hapur, raportimi i arsyetuar.
- Testi i kriterit: zbatimi i njëjtë i metodologjisë (60/30/10) për të gjithë kandidatët, pa shmangie nga treguesit e paracaktuar.
- Testi i barazisë: trajtim i njëjtë i situatave të njëjta dhe arsyetim i diferencave kur ekzistojnë.
- Testi i proporcionalitetit: pikët në raport të drejtë me provat (as nën- e as mbi-vlerësim i pajustificuar).
- Testi i arsytimit: lidhje e qartë “provë → nën-kriter → pikë → total”.
- Testi i transparencës: publikim i renditjes dhe tabelave, mundësia e verifikimit publik.

III. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

12. Në përfundim të intervistës, bazuar në të dhënat e nxjerra nga biseda mbi motivimin e kandidimit, si edhe bazuar në aktet dhe dokumentet që janë dorëzuar nga kandidata Naureda Llagami në momentin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumente të paraqitura prej tij sipas kërkesave të Këshillit, si edhe shkresa dhe të dhëna të tjera të kërkuara apo të ardhura zyrtarisht nga institucione të ndryshme, Këshilli ka vënë në bisedim vlerësimin dhe pikëzimin e kandidates Naureda Llagami për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara:

“a) në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës;

b) në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të plotësuar, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në këto dispozita, me kriteret e përgjithshme të vlerësimit të parashikuara në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016;

c) në detajimin e mëtejshëm të kriterëve ligjore të posaçme dhe të përgjithshme të vlerësimit dhe përcaktimin më të hollësishëm të peshës specifike të tyre në pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve të treguar në Kreun II, në Kreun V dhe në Shtojcën 1 të Vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

ç) në shpjegimet e hollësishme lidhur me metodologjinë mbi të cilin bazohet në vlerësimi dhe caktimi i pikëve të miratuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019 “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese”.

A. Meritat profesionale – Historiku Arsimor dhe Profesional

Vjetërsia në profesion

13. Në shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet si kriter vlerësimi “*Vjetërsia në profesion*”. Ndërkohë që, sipas nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a pika 2 shkronja “a” të ligjit nr. 8577/2000, përbën kusht lejimi kandidimi që kandidati

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

të ketë së paku 15 vjet përvojë profesionale si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës (jurist) të nivelit të lartë në administratën publike.

14. Prandaj, Këshilli vlerëson me pikë kohëzgjatjen e të gjithë përvojës profesionale të secilit kandidat, në maksimum deri në 4 pikë, sikurse orientohet në tabelën e përshkallëzuar të pikëzimit të vjetërsisë në profesion të treguar në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

15. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Naureda Llagami, ka ushtruar veprimtaritë profesionale si më poshtë:

- a) Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për periudhën Dhjetor 2018- Tetor 2024.
- b) Konsulente/Eksperte për Delegacionin e Bashkimit Evropian “EURALIUS” (e vetëpunësuar me NIPT L62108011K), për periudhën Maj 2016 – Dhjetor 2018.
- c) Ndihmëse Ligjore, pranë Gjykatës së Lartë, për periudhën Dhjetor 2012 – Prill 2016.
- ç) Konsulente (me kohë të pjesshme) në Projektin “Mbështetje e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës” financiar nga Zyra e Delegacionit Evropian në Kosovë, për periudhën Prill 2012 - Dhjetor 2012.
- d) Këshilltare për Barazinë Gjinore, pranë Ministrisë së Drejtësisë, në Projektin “Ngritja e kapaciteteve për integrimin e çështjeve të barazisë gjinore”, financiar nga UNWOMEN, për periudhën Qershor 2012 – Prill 2013.
- dh) Drejtore, e Drejtorisë së Hartimit dhe Përafrimit të Legjislacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, për periudhën Shkurt 2010 – Gusht 2011.
- e) Këshilltare/Avokate pranë Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS), për periudhën Dhjetor 2001 – Shkurt 2010.

16. Gjithashtu, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., kandidatja Naureda Llagami ka deklaruar se ka përmbushur edhe veprimtaritë profesionale të mëposhtme:

- ë) Anëtare e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës;
- f) Pedagogë e Jashtme, Eksperte e Shkollës së Magjistraturës;
- g) Lektore pranë Shkollës së Avokatisë, pranë Universitetit jo Publik “Albania University”, pranë Fakultetit Ekonomik, Universiteti i Tiranë....

17. Mbështetur në të dhënat e sipërcituara, rezulton se kandidatja Naureda Llagami ka ushtruar veprimtari profesionale në fushat e përcaktuara sipas nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, prej 18 vjet e 10 ditë, vjetërsi kjo që është kusht formal për kualifikimin për në fazën e dytë atë të vlerësimit dhe pikëzimit. Ndërsa

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

vjetërsia totale në profesionin e “*Juristes*”, duke përfshirë të gjitha eksperiencat e tjera në punë, kandidatja Naureda Llagami ka një vjetërsi në punë rreth 22 vite.

18. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “vjetërsia në profesion”, nisur nga ushtrimi i veprimtarive profesionale të sipërcituara, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Naureda Llagami në total me **18 (tetëmbëdhjetë) Pikë**.

Historiku Arsimor

19. Në shkronjën “d” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe ecuria gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të, ndërkohë që edhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 kërkon të vlerësohen rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.

20. Prandaj, Këshilli vlerëson me pikë ecurinë gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të, të secilit kandidat, sipas përshkallëzimit me 1 pikë të notës mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë të notës mesatare mbi 9, sikurse orientohet në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

21. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezultojnë që kandidatja Naureda Llagami ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1997 - 2001 si jurist, në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë, neni 75, 124 të ligjit.

22. Sipas certifikatës së notave të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës rezultojnë se kandidatja Naureda Llagami ka përfunduar studimet universitare me notë mesatare 9.5. Në jetëshkrimin e tij kandidati ka deklaruar se ka përfunduar arsimin e lartë juridik në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës me notë mesatare 9.5.

23. Për sa më lart, nisur nga përllogaritja e kryer nga Këshilli sipas të cilës nota mesatare e arritur nga kandidatja Naureda Llagami gjatë studimeve dhe diplomimit në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës është 9.5, për kriterin e vlerësimit “*historiku arsimor*”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten në total me **18 (tetëmbëdhjetë) Pikë**.

Kualifikime Pasuniversitare

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

24. Në pikën 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe pikat 1 e 4 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohet si kriter vlerësimi kualifikimet pasuniversitare. Ky kriter vlerëson llojin dhe nivelin e angazhimit të kandidatit në ndjekjen e veprimtarive të kualifikimit profesional që mundësojnë arritjen e një profesionalizmi më të madh në shërbim të ushtrimit të funksioneve dhe detyrimeve profesionale të tilla si, pasja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja e kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.

25. Referuar kriterëve ligjore të vlerësimit dhe metodologjisë së pikëzimit, që gjejnë pasqyrim në mënyrë të detajuar në Shtojcën nr. 1 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, kualifikimeve pasuniversitare, si një nga indikatorët me të cilët vlerësohet niveli profesional i kandidatëve, u janë caktuar në total 8 pikë.

26. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

27. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton se kandidatja Naureda Llagami ka ndjekur studimet pasuniversitare 2004 – 2006 “*Master në Studimet Evropiane*” pranë Universitetit të Tiranës, pra kandidatja ka master në nivel ekzekutiv. Ndërkohë sipas vërtetimit datë 15.10.2024, kandidatja Naureda Llagami vijon studimet pasuniversitare për gradën shkencore “*Doktor*” prej viti 2021 e në vijim, pranë Fakultetit të Drejtësisë Tiranë, Universiteti i Tiranës.

28. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Caktimin e Pikëve udhëzohet se për studimet pasuniversitare në nivelin “*Master në Studimet Evropiane*”, master në nivelin ekzekutiv, vlerësimi është 2-3 (dy - tre) Pikë. Për këto arsye, për këtë kriter vlerësimi, Këshilli çmoi, sikurse dhe për kandidatët e tjerë për këtë kategori, ta vlerësojë kandidaten Naureda Llagami, në total me **27 (njëzet e shtatë) Pikë**.

29. Për treguesin e vlerësimit “*Trajnimet e tjera*”, vlerësohen veçanërisht trajnime me një kohëzgjatje minimale 2 javore, duke mbajtur parasysh edhe numrin, llojet, tematikat dhe kohëzgjatjet e përgjithshme të trajnimeve në fusha të caktuara, institucionet trajnuese,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

si dhe nëse trajnimet janë shoqëruar me një certifikatë vlerësimi. Lidhur me këtë kriter vlerësimi, Këshilli mund të caktojë deri në 2 pikë.

30. Nga akti dokument i jetëshkrimit të kandidatit që ndodhet në dosjen e kandidimit rezulton se kandidatja Naureda Llagami, deklaroi se ka kryer këto trajnime:

- Periudha : **2002**, “Kurs intensiv në College of Advocacy për Shërbimet Ligjore Falas (Legal Aid), Instituti Benchmark, San Francisko, Kaliforni USA”.
- Periudha : **2004**, “Kurs tre javor "The Regional Advanced Programme on Human Rights" organizuar nga Raoul Wallenberg Institute - Lund University, Suedi”;
- Periudha : **2005** “Kurs trajnimi mbi "European System of Human Rights Protection"- organizuar nga Evropa-Universiteti Viadrina Frankfurt (Oder), Gjermani”.
- Periudha : **2006** “Kurs trajnimi nga Këshilli i Evropës për administrimin e gjykatave, Dijon, Francë”.
- Periudha : **2009** “Trajnim mbi "Procedurat përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut", organizuar nga ERA, Strasburg, Francë”.
- Periudha : **2013** “Kurs trajnimi 3 javor "Për fuqizimin e administrimit të drejtësisë", organizuar nga Asser Institute Hagë, Holandë”.
- Periudha : **2014** “Trajnim në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në kuadër të programit të Këshillit të Evropës CEPEJ mbi efikasitetin e gjykatave, për zbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së dhe standardeve të vendosura prej tyre në praktikën gjyqësore shqiptare”.
- Periudha : **2019** “Kurs trajnimi për shkrimin ligjor në Universitetin e Tulan, New Orleans, USA”.

31. Gjithashtu kandidatja Naureda Llagami, edhe pse nuk i ka deklaruar disa trajnime, prej saj janë paraqitur certifikatat e lëshuara nga institucioni që ka organizuar trajnimet, si më mëposhtme:

- Periudha : **1997** “Certifikatë Sister Doris Cavanaugh Scholarship”.
- Periudha : **Maj 2000** “Kurs trajnimi 5 javor “E drejta mbi pasurit e paluajtshme” organizuar nga USAID”.
- Periudha : **16-20 Tetor 2000** “Trajnim “E drejta Penale Ndërkombëtare dhe Krimi i Organizuar” në Universitetin e Tiranës, në bashkëpunim me Universitetin e Kopenhagenit.
- Periudha : **Korrik 2000** “Kurs trajnimi për “rolin e ndërmjetësit për menaxhim dhe zgjidhje konfliktesh” Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë SOROS dhe Fondacioni “Zgjidhja e konflikteve”.
- Periudha : **13-23 Mars 2000** “Kurs trajnimi për “Njohjen e Ligjshmërisë për Mjedisin” nga Qendra Rajonale e Mjedisit, Shqipëri (REC) dhe Fondacioni Soros.

- Periudha : **2-5 Nëntor 2000** “Kurs trajnimi për “Ngritja e Fondeve, hartimi, drejtimi, monitorimi dhe vlerësimi i projekteve” nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë SOROS.
- Periudha : **Dhjetor 2003** “Trajnimi “në lidhje me standardet e reja ligjore që sjell Kodi i ri i Familjes”, organizuar nga Qendra Avokatore për Gra.
- Periudha : **27-30 Shtator dhe 3-6 Nëntor 2004** “Kurs trajnimi “Trajnimi i Trajnerëve” organizuar nga Këshilli i Evropës”.
- Periudha : **13-27 Qershor 2011** “Kurs trajnimi “Prezantim me Administratën Publike” organizuar nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike.
- Periudha : **Prill 2023** “Trajnim “Zbatueshmëria e vendimeve të Gjykatës së Lartë në praktikën gjyqësore dhe administrative” Barsov Rumani.
- Periudha : **Nëntor 2023** “Trajnim “Kushtetutshmëria në veprim” nga Open Gov Hub.

32. Sa më sipër, mbështetur në të dhënat e jetëshkrimit të kandidatit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës, si dhe duke pasur parasysh numrin, llojin, kohëzgjatjen, shtrirjen në kohë dhe tematikat e veprimtarive trajnuese të ndjekura nga kandidatja Naureda Llagami, për këtë kriter ligjor vlerësimi Këshilli çmoi ta vlerësojë në total me **17 (shtatëmbëdhjetë) Pikë**.

Njohja e gjuhëve të huaja

33. Në shkronjën “c” të pikës 4 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohet si kriter vlerësimi niveli i zotërimit të gjuhëve të huaja.

34. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin dhe numrin e gjuhëve të huaja, si edhe nivelin e zotërimit të tyre nga ana e kandidatëve, duke pasur parasysh sasinë e pikëve maksimale përkatëse sipas vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

35. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidatja ka vetëdeklaruar në jetëshkrim se njeh shumë mirë gjuhën Italiane, por nuk ka dorëzuar dokument për të provuar njohjen e gjuhës së huaj Italiane. Gjithashtu kandidatja ka vetëdeklaruar në jetëshkrim se njeh shumë mirë gjuhën Angleze dhe si dokument për të provuar njohjen e gjuhës së huaj angleze ka dorëzuar Dëshmi nr.4674 regj, datë 31.05.2003 pranë Universiteti të Tiranës, Fakultetit i Gjuhëve të Huaja ku është vlerësuar me notën 8, si dhe “certifikatë Aptis, “*Listening niveli B2*” dhe “*Reading niveli C*”, lëshuar nga British Council në datë 21.05.2022.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

36. Në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Caktimit të Pikëve lidhur me këtë kriter vlerësimi citohet ndër të tjera se, për vlerësimin e njohurive për gjuhët e huaja, në rastet kur Këshilli e vlerëson të nevojshme, do të caktojë ekspertë të gjuhës së huaj, të cilët japin mendim për shkallën e zotërimit të aftësive gjuhësore të kandidatit/es. Shkalla e zotërimit të aftësive gjuhësore të kandidatit/es mund të vlerësohet deri në 3 Pikë. Gjithashtu, Këshilli mban parasysh edhe zotërimin e gjuhëve të tjera të deklaruara për të cilat kandidati/ja nuk testohet gjatë intervistës, me kushtin që të jenë të shoqëruara me dokumente vlerësuese të vlefshme për nivelin e njohurive të tyre. Në këtë rast, krahas vlerësimit konkret me pikë për gjuhën e huaj të zgjedhur prej tij/saj për pikëzim, kandidatit/es mund t'i shtohet 1 Pikë.

37. Kandidatja Naureda Llagami u intervistua në gjuhën e huaj Angleze, pasi në përgjigje të njoftimit të Këshillit të datës 20.06.2025, ka theksuar se: *“Kërkon të vlerësohet në gjuhën “angleze”*. Gjithashtu, gjatë intervistës së zhvilluar me Këshillin në datën 16.09.2025, për verifikimin e shkallës së zotërimit të gjuhës angleze, kandidatja Naureda Llagami zhvilloi edhe bisedën me ekspertin e zgjedhur nga Këshilli, Etleva Kondi. Në mendimin me shkrim të depozituar pranë Këshillit, ekspertja e njohurive të gjuhës angleze ka ardhur në përfundimin se kandidatja Naureda Llagami *“njuh dhe zotëron shumë mirë gjuhën angleze”*, duke sugjeruar vlerësimin me 3 (tre) Pikë.

38. Për këto arsye, duke pasur parasysh mendimin me shkrim të ekspertes së vlerësimit të shkallës së zotërimit të gjuhës angleze, si edhe faktin që kandidatja Naureda Llagami ka deklaruar se zotëron edhe gjuhën italiane, por nuk paraqiti dokumentacion provues, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Naureda Llagami për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **27 (njëzetë e shtatë) Pikë**.

B. Meritat profesionale – Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional

39. Në shkronjën “ç” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, në lidhje me kualifikimin e përgjithshëm profesional, përcaktohen si kritere vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse.

40. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

parasysh sasia e pikëve maksimale prej 30 pikësh, sipas vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 të KED, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

41. Në rastin e kandidates Naureda Llagami, Këshilli shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e saj profesionale, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të këtij kandidati në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë.

42. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidatja Naureda Llagami ka dorëzuar punimet profesionale si më poshtë vijon:

- Publikimi i artikullit shkencor 2024: "Përdorimi i teknologjisë në sistemin gjyqësor" [https://eajournals.org/gjplr/wp-content/uploads/sites/36/2024/07/The-Use-of-the-Technology-in-Justice-System](https://eajournals.org/gjplr/wp-content/uploads/sites/36/2024/07/The-Use-of-the-Technology-in-Justice-System;);
- Publikimi i artikullit shkencor 2024: "Lidershipi në gjyqësor: Menaxhimi dhe rolet e administrimit në sistemin gjyqësor: <https://eajournals.org/gjp/r/wp-content/uploads/sites/36/2024/04/Leadership-in-the-Judiciary>;
- Kopje e artikullit shkencor: "The Development of Constitutional Review Systems in Europe and the Albanian Context", 2025 (shqip/anglisht).
- Bashkë autore e botimit "Portreti i gjyqtarit" 2024, financuar nga grantet e Islandës, Lihtenshtajnit dhe Norvegjisë përmes fondit të granteve të ZEE (Zonës Ekonomike Evropiane) dhe Norvegjisë;
- Bashkë autore për hartimin e Manualit "Për të drejtën e pronësisë", të mbështetur nga Këshilli i Evropës 2017 (<https://rm.coe.int/training-manual-on-property-rights-eng/16808b7c6c>);
- Eksperte për monitorimin e rekomandimit të Opinionit të BE-së lidhur me të drejtat e njeriut dhe gjyqësorin. "Monitorimi i planit të veprimit që adreson 12 rekomandimet e Opinionit të BE" 2012 SOROS/OSFA (<https://www.osfa.al/publication/fondacioni-prezanton-raportin-qytetar-te-monitorimit-te-planit-te-veprimit-per-adresimin>);
- Eksperte për hartimin e raportit të monitorimit mbi qëndrueshmërinë e administratës publike për vitin 2009. Publikuar në mars 2010, nga Qendra Akses, financuar nga Ambasada Gjermane; (bashkëlidhur kopje), si dhe dhënia e komenteve dhe sugjerimeve për "Planin e veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Parandalimit, luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes transparente", Dhjetor 2011.
- Eksperte e TLAS për hartimin e "Raporti i monitorimit të zbatimit të ndryshimeve të ligjit "Për gjendjen civil" 2009, mbështetur nga UNICEF.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

- Procesverbalet parlamentare të projektligjit “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” dhe projektligjit “Për investimet e huaja”.
- Eksperte/trajnere për hartimin e moduleve lidhur me trajnimin për administratën gjyqësore në 10 gjykata pilot financuar nga USAID në (<https://pdf.usaid.gov/pdf/docs/PNADW363.pdf>); 2010.
- Relacione nr. 11243-00464-00-2011, çështja nr. 11115-00920-00-2011, çështja me nr. 31003-03901-00-2014 (MF kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës; F.Y kundër A.LL; Marketing and Distribution kundër KPP).
- Relacion me nr. 2475 prot., datë 02.05.2019 dhe Projektvendim për miratimin e Raportit "Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018", miratuar me vendimin Nr.69, datë 03.05.2019 të KLGJ-së.
- Relacion me nr. 3901 prot., datë 18.07.2019 dhe Projektvendim për miratimin e " Planit Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për Sistemin Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë viti 2019-2020", miratuar me vendimin Nr.126, datë 19.07.2019 të KLGJ-së.
- Relacion me nr. 1550 prot., datë 03.03.2020 dhe Projektvendim për miratimin e "Rregullore Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave dhe Deklarimin e Pasurive në Ushtrimin e Funksioneve Publike në Këshillin e Lartë Gjyqësor", miratuar me vendim Nr. 118, datë 05.03.2020 të KLGJ-së.
- Projektvendim Për miratimin e "Raport mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për Vitin 2019", miratuar me vendimin Nr. 148, datë 05.05.2020 të KLGJ-së.
- Relacion me nr. 4414 prot., datë 17.09.2020 dhe Projektvendimi për “Përcaktimin e Kritereve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata", miratuar me vendimin Nr.338, datë 24.09.2020 të KLGJ-së.
- Relacion me nr. 5344 prot., datë 21.10.2020 dhe Projektvendimi "Për caktimin e strukturës së posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar, në Këshillin e Lartë Gjyqësor", miratuar me vendimin nr. 493, datë 21.10.2020 të KLGJ-së.
- Relacion me nr.6117 prot., datë 09.12.2020 dhe Projektvendim "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", miratuar me vendimin Nr.622, datë 10.12.2020 të KLGJ-së.
- Relacion me nr. 6320 prot., datë 23.12.2020 dhe Projektvendim "Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësisë të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë", miratuar me vendim Nr.643, datë 23.12.2020 të KLGJ-së.
- Relacion me nr. 1091 prot., datë 11.03.2021 dhe Projekt- Udhëzimi "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

*Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302*

- së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurrimit të hapur", miratuar me Udhëzim Nr.85, datë 11.05.2021 të KLGJ-së.
- Projektvendim Për miratimin e "Raporti Vjetor i Sistemit Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor për Vitin 2020", miratuar me vendimin Nr. 176, datë 29.04.2021 të KLGJ-së.
 - Relacion me nr.4521 prot., datë 05.10.2021 dhe Projektvendim "Për miratimin e rregullores "Për shqyrtimin e praktikave korruptive në Këshillin e Lartë Gjyqësor", miratuar me vendim Nr. 441, datë 05.10.2021 të KLGJ-së.
 - Relacion me nr. 4522 prot., datë 05.10.2021 dhe Projektvendim për miratimin e rregullores "Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Këshillin e Lartë Gjyqësor", miratuar me vendim Nr. 442, datë 05.10.2021 të KLGJ-së.
 - Relacion me nr. 4523 prot., datë 05.10.2021 dhe Projektvendim për miratimin e rregullores "Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit dhe mbrojtjen nga hakmarrja në Këshillin e Lartë Gjyqësor", miratuar me vendim Nr. 443, datë 05.10.2021 të KLGJ-së.
 - Relacion me nr.501 prot., datë 26.01.2022 dhe Projektvendim "Për krijimin dhe vënien në funksion të regjistrit elektronik të organizatave jofitimprurëse", miratuar me vendim Nr. 35, datë 26.01.2022 të KLGJ-së.
 - Relacion me nr. 786 prot., datë 08.02.2022 dhe Projekt - Udhëzimi "Për mënyrën dhe procedurën e kompensimit, për orët shtesë të kryera mbi kohën normale të punës, nga nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjësit e tjerë administrativë, në gjykatë miratuar me Udhëzim Nr.48, datë 08.02.2022 të KLGJ-së.
 - Relacion me nr. 2292 prot., datë 20.04.2022 dhe Projektvendim për miratimin e "Raport mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për Vitin 2021", miratuar me vendimin Nr. 156, datë 20.04.2022 të KLGJ-së.
 - Relacion me nr. 2659 prot., datë 11.05.2022 dhe Projektvendim, "Për miratimin e Planit Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, viti 2022-2024", miratuar me vendimin Nr. 184, datë 11.05.2022 të KLGJ-së.
 - Relacion me nr. 6648 prot., datë 29.12.2022 dhe Projektvendim, mbi miratimin e rregullores "Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor", miratuar me vendimin Nr. 558, datë 29.12.2022 të KLGJ-së.
 - Relacion me nr.6649 prot., datë 29.12.2022 dhe Projekt - Udhëzimi "Për përcaktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të gjyqtarit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm ose për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë", miratuar me Udhëzim Nr.559 datë 29.12.2022 të KLGJ-së.
 - Relacion me nr. 2570 prot., datë 26.04.2023 dhe Projektvendim për miratimin e "Raport mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

- Gjyqësor për Vitin 2022", miratuar me vendimin Nr. 196 datë 26.04.2023 të KLGJ-së.
- Relacion me nr. 4275 prot., datë 24.07.2023 dhe Projektvendim "Për miratimin e formularëve standard të regjistrit elektronik të organizatave jofitimprurëse", miratuar me vendimin Nr.445 datë 24.07.2023 të KLGJ-së.
 - Rregullore me nr. 465 prot., datë 24.01.2024 dhe Projektvendim mbi miratimin e Rregullores "Për zhvillimin e procedurave disiplinore për nëpunësit civilë gjyqësorë", miratuar me vendimin Nr.22 datë 24.01.2024 të KLGJ-së.
 - Relacion me nr. 841 prot., datë 07.02.2024 dhe Projektvendim për miratimin e "Raportit Vjetor mbi Veprimtarinë e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit për Vitin 2023", miratuar me vendimin Nr.50, datë 07.02.2024 të KLGJ-së.
 - Relacion me nr. 2326 prot., datë 25.04.2024 dhe Projektvendim për miratimin e "Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2023", miratuar me vendimin Nr.210 datë 25.04.2024 të KLGJ-së.
 - Relacion me nr.2336 prot., datë 25.04.2024 dhe 2 (dy) Projektvendime :
 - a) Mbi miratimin e "Planit strategjik 2024 - 2025 për trajnimin fillestar dhe vazhdues të nëpunësve civilë gjyqësorë", miratuar me vendimin Nr.223, datë 25.04.2024 të KLGJ-së.
 - b) Mbi miratimin e "Rregullores për formimin profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë", miratuar me vendimin Nr.224, datë 25.04.2024 të KLGJ-së.
 - Relacion me nr. 2337 prot., datë 25.04.2024 dhe Projektvendim "Mbi përcaktimin e tarifave për trajnerë/ekspertë e lehtësues, që do të ofrojnë programin e formimit fillestar dhe vazhdues për nëpunësit civilë gjyqësorë", miratuar me vendimin Nr.225, datë 25.04.2024 të KLGJ-së.
 - Relacion me nr.3035 prot., datë 05.06.2024 dhe Projektvendim mbi miratimin e rregullores "Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor", miratuar me vendimin Nr.289, datë 05.06.2024 të KLGJ-së.

43. Mbështetur në këto të dhëna të rezultateve në ushtrimin e detyrës, si dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale të lidhura me ushtrimin e detyrës apo edhe me ushtrimin e profesionit, konkretisht si Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndihmëse ligjore në Gjykatë të Lartë apo eksperiencia në Ministri të Drejtësisë, Këshilli vlerëson se *në aspektin sasior* kandidatja Naureda Llagami ka tregues të lartë angazhimi profesional, i cili rezulton të jetë mbi atë që mund të gjykohet si një angazhim i zakonshëm apo "mesatar" në ushtrimin e profesionit. Për këto arsye, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Naureda Llagami për këtë kriter ligjor vlerësimi në total me **43 (dyzet e tre) Pikë**.

44. Për sa i përket *vlerësimit cilësor*, Këshilli shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja Naureda Llagami, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej tij, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

*Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302*

shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionale dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatit dëshmojnë spikatjen dhe dallueshmërinë e tij në kuptimin dhe qëllimin për të cilin Kushtetuta dhe ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Këshill dhe, më tej, për përzgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nga organet e emërtesës.

45. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, kandidatja Naureda Llagami ka depozituar pranë Këshillit dokumentacionin përkatës për vlerësim, dhe ka përcaktuar për vlerësim **5 (pesë)** dokumente specifik si vijon:

“- Plani Strategjik i KLGJ-së (2019–2021), në përputhje me objektivat e ligjit “Për qeverisjen e sistemit gjyqësor” dhe në bashkërendim me dokumentet strategjike kombëtare për drejtësinë;

- Vendim nr. 558, datë 29.12.2022 i KLGJ, mbi miratimin e rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor”;

- “Raport bazë për menaxhimin e të dënuarve për ekstremizëm të dhunshëm dhe parandalimin e radikalizimit në burgje dhe në shërbimin e provës në Shqipëri”, me mbështetjen e OSBE-së;

- Manualit mbi të Drejtën e Pronësisë, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, i përdorur si mjet trajnimi për gjyqtarë dhe praktikues ligjorë;

- Raporti vlerësues i Gjykatës për Krime të Rënda – “Impact baseline on serious crimes court in the context of constitutional and legal amendments”, me mbështetjen e Ambasadës Britanike;”.

46. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidatja Naureda Llagami, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi, Këshilli shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e tyre, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë edhe ato të përmendura në Shtojcën nr. 1 të vendimit sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientime që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

47. Dokumentet profesionale të shqyrtuara trajtojnë tematika të ndryshme që lidhen me: *akte të cilat kanë shërbyer për mbarëvajtjen e institucioneve të caktuara konkretisht me KLGJ-në; publikime profesionale; akte të tjera që lidhen me dokumente ligjor të marra gjatë ushtrimit të detyrës me tematika nga fusha të ndryshme.*

48. Njëri ndër indikatorët vlerësues të dokumenteve profesionale është *“Origjinaliteti dhe/ose impakti”*, duke marrë në konsideratë faktin se nuk ka të dhëna për plagjiaturë të dokumentit. Nisur nga profili profesional dhe angazhimi shkencor i kandidates Naureda Llagami, përmbajtja e dokumenteve të përzgjedhura, dobisë së përdorimit të tyre nga profesionistë të fushës por edhe nga grupe interesi dhe publiku i gjerë, Këshilli vëren se publikimet dhe artikujt e analizuar dëshmojnë qasje profesionale origjinale veçanërisht mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe aspekteve kushtetuese lidhur me to,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

çështje për të cilat jo vetëm në kohën e publikimit por edhe aktualisht ka një nevojë të veçantë për njohje dhe zbatim. Ajo që veçohet për kandidaten Naureda Llagami është kontributi i saj në organizmin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, kjo për shkak të detyrës së saj si Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

49. Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me “*Aftësitë analitike*”, Këshilli vëren se posaçërisht pesë dokumentet profesionale të shqyrtuara, sikurse edhe në rastin e publikimeve dhe artikujve profesionalë, kandidatja Naureda Llagami tregon zotërimin e aftësive të larta për të analizuar informacionin dhe për të identifikuar, arsyetuar dhe zbatuar konceptet ligjore, parimet dhe institutet e së drejtës, sipas natyrës dhe qëllimit të vetë këtyre punimeve.

50. Në lidhje me treguesin vlerësues “*Aftësitë kërkimore*”, Këshilli shqyrtoi dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Naureda Llagami, sikurse edhe publikimet dhe artikujt profesionalë, të paraqitur në dosjen e kandidatit. Nga ky shqyrtim, Këshilli vëren se këto punime përmbajnë informacione të lidhura me fusha të larmishme të së drejtës, kryesisht me të drejtat e njeriut, për sistemin gjyqësor, për përmirësimin e legjislacionit në fushat të caktuara etj. Për arritjen e lëndës së trajtuar dhe qëllimin e trajtimit shkencor, nga përmbajtja e secilit prej punimeve të shqyrtuara, adresohen analiza krahasimore duke përdorur burime të ndryshme të doktrinës dhe praktikës gjyqësore, vendase dhe ndërkombëtare.

51. Për treguesit “*Saktësia dhe precizoni*”, në thelb, u verifikua nëse në veprimtarinë profesionale të kandidatit janë mbuluar me profesionalizëm tematika e përzgjedhur dhe materiali ka shmangur përsëritjet apo citimet e panevojshme etj. Nga shqyrtimi i dokumenteve profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Naureda Llagami, Këshilli vëren se këto punime tregojnë nivel të lartë të parashtrimit të problemeve juridike për analizë dhe zgjidhje, përdorim korrekt të terminologjisë juridike dhe të gjetjeve nga legjislacioni, doktrina, si edhe praktika gjyqësore.

52. Në lidhje me treguesin vlerësues “*Qartësia*”, Këshilli shqyrtoi dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Naureda Llagami, sikurse edhe publikimet dhe artikujt profesionalë të paraqitur në dosjen e kandidatit. Këshilli vëren se këto punime janë të organizuara dhe strukturuara në mënyrën e duhur, gjuha e përdorur është e pasur dhe profesionale. Qartësia e gjuhës së përdorur dhe strukturimi i materialit i bëjnë këto punime të kuptueshme dhe të lexueshme, sipas natyrës së punimit dhe grupeve të interesit të cilave synon ti drejtohet.

53. Këshilli, pasi shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja Naureda Llagami, për sa i përket vlerësimit cilësor, rezulton se tregojnë që kandidatja zotëron impakt praktik dhe profesional, aftësi analitike dhe kërkimore domethënëse, saktësi dhe qartësi në hartimin e akteve, për rrjedhojë vjen në

përfundimin se kandidatja Naureda Llagami vlerësohet në total me **201 (dyqind e një) Pikë**.

C. Meritat profesionale – Kualifikimi Shtesë Profesional

54. Në shkronjën “b” të pikës 2 dhe shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, në lidhje me kualifikimin e shtesë profesional, përcaktohen si kritere vlerësimi që kandidatët të kenë veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut dhe në sfera të tjera të së drejtës, vlerësim të dallueshëm të rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, përvojë të veçantë në një fushë të caktuar të së drejtës, si edhe pjesëmarrje të dallueshme në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës.

55. Prandaj, në zbatim të ligjit, në varësi edhe të profileve dhe karrierave profesionale të secilit kandidat, nga totali prej 12 pikësh për këtë kategori vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 8 pikë ekspertizën në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose ekspertizën në fusha të tjera të veçanta të së drejtës. Gjithashtu, Këshilli vlerëson deri në 4 pikë angazhimet profesionale shtesë të kandidatëve. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

Specializimi në të drejtën kushtetuese, të drejtat e njeriut ose në fusha të tjera të së drejtës

56. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, *ekspertizës në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose ekspertizës në fusha të tjera të veçanta të së drejtës*, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe dokumente të tjera zyrtare mbi rezultate të vlerësimit profesional etj., si edhe nga shqyrtimi i dokumentet profesionale të paraqitura nga kandidatja Naureda Llagami, Këshillit i rezulton se karriera profesionale e kësaj kandidate është fokusuar në fushën e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe drejtësisë kushtetuese, si lektor, ekspert ligjor dhe koordinator në disa projekte, kombëtare dhe ndërkombëtare.

57. Këshilli vëren se në formimin profesional, specializimin dhe ekspertizën e posaçme profesionale të fituar nga kandidatja Naureda Llagami, një rol të veçantë ka edhe interesi

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

i treguar vetjak profesional për ushtrimin e vazhdueshëm të veprimtarive profesionale si Lektor pranë Shkollës së Magjistraturës apo pranë universiteteve publike dhe private. Nga ana tjetër, edhe studimet pasuniversitare të ndjekura, ka ndikuar në formimin profesional dhe specializimin e këtij kandidati në fushën e të drejtave të njeriut.

58. Së fundi, si rrjedhojë dhe reflektim i përgatitjes profesionale dhe përvojës së fituar, kandidatja Naureda Llagami në cilësinë e autorit ka realizuar punime profesionale dhe artikuj shkencore, të cilat në pjesën më të madhe të tyre, trajtojnë aspekte të ndryshme të së drejtës, veçanërisht e lidhur me njohjen, respektimin dhe mbrojtjen e lirive themelore e të drejtave të njeriut.

59. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të *“ekspertizës në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose në fusha të tjera të së drejtës”*, përvoja e veçantë e kandidatës në një fushë të caktuar të së drejtës, të drejta e njeriut etj, përbëjnë elementë vlerësues domethënës, Këshilli vlerëson t’i caktojë kandidatës Naureda Llagami në total **67 (gjashtëdhjetë e shtatë) Pikë**.

Angazhime profesionale shitesë

60. Nga aktet e dosjes dhe nga vetëdeklarimet e kandidatja Naureda Llagami, rezulton se ka pasur këto angazhime shitesë profesionale:

- a) Folëse në konferencën e Organizatës Ndërkombëtare për Administrimin Gjyqësor, shtator 2019, në Nur-Sultan, të Kazakistanit me temën: "Mundësitë dhe Sfidat e Gjykatave në Botë", <https://klgj.al/2019/09/kryetarja-e-keshillit-te-larte-gjyqesor-znj-naureda-llagami-po-merr-pjese-ne-konferencen-e-organizates-nderkombetare-peradministrimin-gjyqesor-e-cila-zhvillohet-ne-nur-sultan-te-kazakistanit-ne/>
- b) Folëse në konferencën evropiane drejtësia restauruese me temën: "Roli i KLGJ-së në promovimin e drejtësisë restauruese për fëmijët";
- c) Folëse në tryezën ndërkombëtare me temën: "Administrimi i gjykatave dhe statistikat si mjete strategjike për përmirësimin e performancës"; (bashkëlidhur moduli i hartuar):
- d) Folëse në tryezën ndërkombëtare "Kultura gjyqësore dhe vetëqeverisja", shtator 2021. Beograd: <https://idscs.org.mk/en/2021/09/28/judicial-culture-and-judicial-self-governance-discussed-at-experts-workshop-co-organised-by-idscs-and-cepris/>
- e) Folëse në tryezën ndërkombëtare me temë "Formësimi i Këshillave Gjyqësor për të përballuar sfidat bashkëkohore" <https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf>
- f) Folëse në Shkollën e Integritit Evropian, 24-28 Tetor 2022, organizuar nga Këshilli i Integritit në Kuvendin e Shqipërisë dhe Delegacioni i BE me temën "Roli i drejtësisë në çështjet e integritit të BE";
- g) Folesë në seminarin ndërkombëtar organizuar nga CCJE/ENCJ lidhur me "Rastin/Modelin procesit të rivlerësimit (vetting) në Shqipëri" prill 2023;

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

- h) Folëse në forumin ndërkombëtar organizuar nga OpenGovHub "Reforma e drejtësisë në Shqipëri: Konstitucionalizmi në veprim": nëntor 2023, Washington DC. USA: <https://www.eventbrite.com/e/justice-reform-in-albania-constitutionalism-in-action-tickets -753320029487>;
- i) Pedagoge e jashtme e Shkollës së Magjistraturës nga 2019 e në vazhdim; (vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës);
- j) Eksperte e Shkollës së Magjistraturës për ndihmën juridike, të drejtën e pronës dhe këshillat e gjykatës;
- k) Lektore pranë Shkollës së Avokatisë për temën "Gjykimi administrativ në shkallën e parë" 2018;
- l) Lektore e së Drejtës Ndërkombëtarë Private në ciklin e parë të studimeve pranë Universitetit jo publik TBU 2011-2013;
- m) Lektore e së Drejtës Administrative në programin e studimit Diplomë e integruar e Nivelit të dytë të shkencave Juridike, si dhe në lëndën "Parimet e përgjithshme të së drejtës" në programin e studimit bachelor në Shkenca Politike në Universitetin jo Publik "Albania University" gjatë viteve akademike 2008-2011;
- n) Përfaqësues e Qeverisë Shqiptare në Konferencën e Palëve (COP), mekanizëm i cili vlerëson zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për pastrimin, kerkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit" CETS N°198. ([www.coe.int/t/dghl/monitoring/cop198/.../C198-COP\(2011\)REP3 en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/cop198/.../C198-COP(2011)REP3_en.pdf));
- o) Lektore e së Drejtës Administrative në trajnimin për auditues i brendshëm në sektorin publik 2009;
- p) Lektore e së Drejtës së Biznesit në ciklin e parë të studimeve pranë Fakultetit Ekonomik, Universiteti i Tiranës, 2006-2007.

61. Nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe dokumentet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidimit, rezulton se kandidatja Naureda Llagami, krahas periudhës të përlllogaritur si vjetërsi në profesion, ka ushtruar edhe veprimtari profesionale shtesë si lektor me kohë të pjesshme, eksperte, pjesëmarrëse apo folëse në konferenca, seminare, tryeza etj. Këto angazhime shtesë profesionale janë të lidhura me kontribute dhe pjesëmarrje në përgatitjen e analizave ligjore dhe studimeve mbi çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut etj.

62. Prandaj, duke pasur parasysh këto angazhime shtesë profesionale, të shtrira në kohë dhe me kontribute konkrete profesionale në disa nga fushat më të rëndësishme të së drejtës, eksperte në organizata të ndryshme, Këshilli vlerëson që për kriterin vlerësues të "*angazhimeve profesionale shtesë*", t'i caktojë kandidatet Naureda Llagami në total me **33 (tridhjetë e tre) Pikë**.

Meritat Morale

63. Në shkronjën "c" të pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 si kriter vlerësimi është përcaktuar që kandidatët të jenë vlerësuar për "*integritetin etik e moral*". Po kështu, në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 përcaktohen si kriter "*Rezultatet*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

e vlerësimit të etikës së kandidatëve gjatë punës, nëse ka”, ndërsa në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni përcaktohen si kriter vlerësimi edhe “*Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*” dhe “*cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi*”. Së fundi, në shkronjën “c” parashikohet si kriter vlerësimi edhe “*angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*”. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kriter vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kriterëve.

64. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 30 pikësh për të tre komponentët vlerësues, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 18 pikë *integritetin etik dhe moral*, deri në 10 pikë *reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve* dhe deri në 2 pikë *angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli dhe Shtojcën nr. 1 të tij, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

65. Në lidhje me “meritat morale”, krahas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi, mbahen parasysh edhe gjetjet në procedurën e verifikimit të kandidatit, ku përmbahen të dhëna që kanë të bëjnë apo mund të përdoren për efekte të vlerësimit të integritetit etik e moral të kandidatit, angazhime në kauza të shoqërisë civile etj. Gjithashtu, për këtë komponent të vlerësimit mbahen parasysh edhe të dhëna e përfundime që mund të nxirren gjatë intervistës së kandidatit me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

66. Nga kandidati në lidhje me këtë kriter janë dorëzuar dokumente që kanë të bëjnë me vlerësime të marra nga institucionet pranë të cilës kandidati ka ushtruar veprimtarinë profesionale, si dhe referenca mbi cilësitë personale dhe profesionale të kandidatit nga bashkëpunëtorë të tij.

67. Në rastin e kandidates Naureda Llagami, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve në intervistë, motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Këshillin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave morale të këtij kandidati.

Integriteti etik e moral

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

68. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, *integritetit etik e moral*, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga të dhëna të tjera të disponueshme, përfshi rrethanat e përfundimit të marrëdhënies së saj të punësimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, Gjykatës së Lartë apo institucioneve të tjera publike dhe jopublike, Këshilli i rezulton se kandidatja Naureda Llagami në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e tij tregon angazhim të ndërgjegjshëm në përmbushjen e detyrave profesionale dhe në ushtrimin e profesionit, si edhe vëmendje për t'iu përgjigjur me kujdesin e duhur pyetjet të cilat i drejtohen nga bashkëbiseduesit.

69. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*integritetit etik e moral*”, duke qenë se nuk ka masa disiplinore, ka profil të qëndrueshëm etik, gëzon integritet si figurë publike, Këshilli vlerëson ti caktojë kandidates Naureda Llagami në total me **161 (njëqind e gjashtëdhjetë e një) Pikë**.

Reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve

70. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues “*reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*”, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshilli i rezulton se kandidatja Naureda Llagami në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e tij nuk heziton të tregojë angazhim në përmbushjen e detyrave të tij. Sipas të dhënave që disponohen Këshilli i rezulton se kandidatja Naureda Llagami reflekton përgjegjshmëri në angazhimet e saj profesionale.

71. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*”, ka vlerësim të mirë në komunikimin juridik dhe institucional, figurë publike e njohur me ekspozim të lartë publik për shkak të rolit të saj si Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, gëzon reputacion pozitiv në shoqëri dhe midis kolegëve, Këshilli vlerëson ti caktojë kandidates Naureda Llagami **88 (tetëdhjetë e tetë) Pikë**.

Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile

72. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues “*angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*”, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshilli i rezulton se kandidatja Naureda Llagami ka qenë e angazhuar në veprimtari të tjera profesionale, në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Për më tepër kandidatja Naureda Llagami si pjesë aktive në shoqërinë civile, është zgjedhur si përfaqësuese e shoqërisë civile në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

73. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*”, ka aktivitet të vazhdueshëm publik dhe institucional me fokus interesin publik e forcimin e sundimit të ligjit, Këshilli vlerëson kandidatja Naureda Llagami në total me **16 (gjashtëmbëdhjetë) Pikë**.

Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale

74. Në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016 parashikohen si kriteret vlerësimi disa komponentë të lidhura me aftësitë profesionale dhe personale të kandidatëve mbi çështjet e natyrës drejtuese, organizative, të kapacitetit për vendimmarrje, punës në grup, të komunikimit dhe përfaqësimit publik. Kështu, në pikën 3 të këtij neni parashikohen kriteret vlerësuese për kandidatët si më poshtë:

- “a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin”;*
- b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;*
- c) aftësitë e komunikimit;*
- ç) aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;*
- d) aftësitë e përfaqësimit publik”.*

75. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kriteret vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kriterëve.

76. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale, nga totali prej 10 pikësh për të pesë komponentët vlerësues të sipërcituar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 3 pikë *cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin* kandidatët, deri në 4 pikë *aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore*, deri në 2 pikë *aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik*, si edhe me 1 pikë për *aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore*. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij, Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli dhe Shtojcën nr. 1 të tij, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

77. Në rastin e kandidates Naureda Llagami, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së motivimit për kandidim dhe

historikut të komunikimit të kandidatit me Këshillin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale të këtij kandidati.

Cilësia e platformës dhe të vizionit

78. Këshilli shqyrtoi përmbajtjen e dokumentit me shkrim, platformës mbi motivimin e kandidimit dhe vizionit të kandidates Naureda Llagami lidhur me qasjen dhe qëndrimet e saj mbi rëndësinë dhe aspektet thelbësore të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, mbi sfidat kryesore me të cilat është përballur dhe duhet të përballët Gjykata Kushtetuese në ushtrimin e përgjegjësve dhe kompetencave që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji. Gjithashtu, në vlerësimin e këtij kriteri, Këshilli mban parasysh edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhëna nga ky kandidat gjatë intervistës dhe në përgjigje të pyetjeve që iu drejtuan nga anëtarët e Këshillit.

79. Nisur nga dokumenti me shkrim dhe shpjegimet e paraqitura gjatë intervistës, Këshilli vëren se kandidatja Naureda Llagami ka njohuritë mbi rëndësinë e misionit, kërkesave etike morale dhe profesionale që dikton pozicioni i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese si edhe të kësaj Gjykate, në respektimin e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe në tërësi të mirëfunksionimit të sistemit demokratik dhe shtetit ligjor. Gjithashtu, kjo kandidate parashtrori aftësitë dhe përkushtimin e saj për përmbushjen e misionit të Gjykatës Kushtetuese.

80. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*cilësia e platformës dhe të vizionit të paraqitur*”, duke qenë se ka platformë koherente me fokus në efikasitetin, transparencën dhe standardet e shtetit të së drejtës, e strukturuar mirë dhe e plotë, Këshilli vlerësoi t’i caktojë kandidates Naureda Llagami në total me **25.5 (njëzetë e pesë pikë pesë) Pikë**.

Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore

81. Lidhur me aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, Këshilli mbështetet pikësisht në të dhënat që lidhen me përvoja konkrete nga karriera e kandidatëve në funksione dhe pozicione të cilat kërkojnë dhe tregojnë marrjen përsipër të përgjegjësi dhe ushtrimin e vendimmarrjes në ushtrimin e kompetencave dhe përmbushjen e detyrave të ngarkuara. Gjithashtu, në vlerësimin e kandidatëve për këtë komponent vlerësimi, Këshilli mban parasysh se ushtrimi i çdo detyre, funksioni dhe veprimtari profesionale, edhe kur formalisht nuk lidhet drejtpërdrejt me të drejtën/detyrimin për ushtrimin e kompetencës vendimmarrëse, gjithsesi përmban

elementë që tregojnë aftësi të provuara ose premtuese për të marrë nisma, për të kërkuar zgjidhje, për të marrë përgjegjësi si edhe vendimet e duhura e në kohën e duhur sipas përcaktimeve të ligjit dhe në përgjigje të ndjeshmërisë së publikut.

82. Në rastin e kandidatës Naureda Llagami, krahas jetëshkrimit, parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së platformës dhe motivimit për kandidim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit, për të evidentuar të dhëna në lidhje me aftësitë e provuara apo premtuese të këtij kandidati për të marrë vendime dhe përgjegjësi edhe në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

83. Këshilli vëren se kandidatja Naureda Llagami, në karrierën e saj profesionale ka ushtruar veprimtari profesionale të natyrës drejtuese dhe bashkërenduese. Konkretisht kjo candidate ka ushtruar funksionin e Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, që mbetet një vlerë e shtuar në këtë kriter. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues *“aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore”*, për shkak të udhëheqjes dhe vendimmarrjes komplekse i një organi kolegjal në cilësinë e Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor dëshmon pjekuri institucionale, Këshilli vlerëson t’i caktojë kandidatës Naureda Llagami në total me **36 (tridhjetë e gjashtë) Pikë**.

Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik

84. Aftësitë e komunikimit, në të gjitha format, sikurse edhe në përfaqësimin publik e me të tretët, të shprehurit në mënyrë të qartë, lehtësisht të kuptueshme, të matur, me respekt dhe në mënyrë jodiskriminuese, luajnë një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

85. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim të platformës, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga përmbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit të dokumenteve profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, apo deklaratat dhe intervista publike që ka dhënë në cilësinë e Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshilli vëren se kandidatja Naureda Llagami zotëron aftësi të mira për të komunikuar me kujdesin e duhur, për të dëgjuar me profesionalizëm dhe për tu përgjigjur në lidhje me të gjitha çështjet dhe problematikat që vlerëson të trajtohen, ashtu edhe për çështje dhe problematika që ngrihen nga të tjerët.

86. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të *“Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik”*, si rezultat i prezantimeve në forume publike dhe profesionale, me vizibilitet të mirë dhe komunikim efektiv dhe të qartë, Këshilli vlerëson ti caktojë kandidatës Naureda Llagami në total me **17.5 (shtatëmbëdhjetë pikë pesë) Pikë**.

Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore

87. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, për vetë natyrën e këtij funksioni, mënyrës së funksionimit dhe kolegjalitetit të kërkuar në veprimtarinë e vendimmarrjen kësaj Gjykate, duhet të zotërojë aftësitë e duhura për një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të qenë i përfshirë në punën në grup, me gjyqtarët e tjerë, këshilltarët dhe anëtarët e stafit të Gjykatës. Pjesë e kësaj aftësie është edhe nevoja për t'u përshtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj nevojës për t'u përfshirë në veprimtari në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore gjatë karrierës gjyqësore.

88. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga dokumentet profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Këshilli vëren se kandidatja Naureda Llagami zotëron aftësi shumë të mira për të punuar në grup dhe ka të dhëna të qarta në drejtim të organizimit të veprimtarive në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore. Prezantimi dhe dokumentet profesionale dëshmojnë se kjo kandidat është përfshirë vijë mësisht në projekte profesionale me kolegë të tjerë, vendas apo të huaj, për realizimin e veprimtarive, publikimeve shkencore dhe artikujve profesionalë.

89. Gjithashtu, zotërimi i këtyre aftësive rezulton i reflektuar edhe në vetë mënyrën e parashtrimit me shkrim të çështjeve në platformën e paraqitur, kryesisht funksionin e kryer si Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si edhe në komunikimin e bisedën e zhvilluar me Këshillin gjatë intervistës.

90. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore*”, si rezultat i punës së provuar në organet kolegjiale (KLGJ) dhe koordinim me aktorë të shumët institucionalë, Këshilli vlerëson ti caktojë kandidatës Naureda Llagami në total me **9 (nëntë) Pikë**.

91. Në përfundim të arsyetimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar më sipër në këtë Vendim (të pasqyruar edhe në tabelat përkatëse që gjenden në faqen zyrtare Gjykatës së Lartë, në Rubrikën KED), në funksion të procedurave ligjore të përzgjedhjes së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për vendin vakante në të cilin ka kandiduar, Këshilli të Emërimeve në Drejtësi i rezulton se kandidatja Naureda Llagami:

- pasqyron profilin institucional si ish drejtuese e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe me përgjegjësi të gjera në qeverisje/politikëbërje gjyqësore,
- ka produkte analitike/trajnimi që transpozojnë standardet evropiane në praktikë (manuale, kurrikula), si dhe aftësi të dokumentuara gjuhësore/trajnimi, si dhe
- gëzon cilësi të larta morale dhe aftësi organizative.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

92. Duke peshuar në mënyrë të integruar të tre blloqet (meritat profesionale, morale dhe organizative) dhe provat e dosjes, zbatimi simetrik i metodologjisë e bën totalin e pikëve **804 : 9 = 89.3 pikë** proporcional, bindës dhe të qëndrueshëm në leximin kolegjal.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/ç të ligjit nr. 8577/2000 “ *Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”, të nenit 239 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, të pikës 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 5 datë 02.04.2019 “*Për Kriteret dhe Procedurën e Vlerësimit, Pikëzimit dhe Renditjes së Kandidatëve për Pozicionet Vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Vlerësimin e kandidates Naureda Llagami, me **89.3 (tetëdhjetë e nëntë pikë tre) pikë** në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga, Gjykata e Lartë në datën datë 11.12.2024.
2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr.115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatja Naureda Llagami.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ANËTAR	Zv/KRYETARE	KRYETAR
Illir Toska	Marjana Semini	Sokol Sadushi
ANËTARE	ANËTAR	ANËTARE
Alma Muça	Fuat Vjerdha	Enkela Vlora
ANËTARE	ANËTARE	ANËTAR
Irma Balli	Nafije Hasko	Etien Kapo

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302